



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 3, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, në pajtim me nenin 4, të Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2010 për Procedurat e Shpalljes së Programeve të Veçanta të Banimit, organi kompetent Komunal, në bazë të përcaktimit të kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjarë bënë:

SHPALLJE PUBLIKE
për programe të veçanta të banimit

1. Përfituesit për programe të veçanta të banimit do të jenë familjet në kushte të rënda sociale dhe ekonomike, që nuk janë në gjendje ekonomike të cilët e kanë të pazgjedhur çështjen e banimit.
2. Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga ky program i veçantë i banimit:
 1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale
 2. Kanë mbetur pa banesë-shtëpi si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë
 3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike

Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë

Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit për personat nga pika 2, janë:

1. Statusi i banimit
2. Lartësia e të ardhurave
3. Gjendja shëndetësore
4. Invaliditeti
5. Struktura e familjes

Struktura e familjes përbën kriterë përparësie shtesë:

- Familje dëshmori
- Familje e kryesuar nga një prind/prindi vetushqyes
- Familje në përkujdesë të fëmijëve jetim

- Aplikuesit që bëjnë kërkesë për të përfituar nga programi i veçantë i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të Komunës së Gjakovës.
- Për zgjedhjen e përfituesve nga programi i veçantë i banimit, përparësi kanë familjet me numër më të madh të pikëve, sipas tabelës së vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të “Udhëzimit administrativ nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit”.
- Aplikacionin në formë standard mund ta tërheqin në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ose në Zyrën e Pranimit, çdo dite pune nga ora 8:00 deri në 16:00. Kërkesa dorëzohet në Zyrën e Pranimit për protokoll.
- Thirrja mbetet e ***hapur 30 (tridhjetë) ditë*** nga dita e shpalljes publike në ueb faqe të Komunës së Gjakovës, duke filluar **më datë 19/03/2025** e deri **më datën 19/04/2025**.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit kohorë, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme, nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen si të pavlefshme.
- Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për t’u kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi të banimit social.
- Ndalohej bërja publike e të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura.
- Përfshihen nga përfitimi nga ky program, familjet që kanë përfituar ndihmë në forma tjera të të njëjtit nivel ose më të lartë se sa mund të përfitohet nga programet e veçanta të banimit.
- Subvencionimi i qirasë bëhet sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.
- Pas shpalljes së listës së familjeve të renditura sipas pikëve të fituara, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë me shkrim kundër vendimit të Komisionit Vlerësues në MMPH, ***brenda tridhjetë (30) ditëve*** nga dita e pranimit të vendimit.

Kërkesës/aplikacionit standard për të përfituar nga ky program i banimit social duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet e listuara si vijojnë:

- Statusi i Banimit

1. Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës- (dorëzohet në versionin e fotokopjuar për të gjithë anëtarët e familjes mbi moshën 16 vjeçare).
2. Familjet të cilat jetojnë në objekte të rrezikshme ose të papërshtatshme për banim (dëshmi: vërtetim nga organi përgjegjës).
3. Familjet të cilat jetojnë me qira (dëshmi kontrata e qirasë e vërtetuar nga noteri).
4. Familjet që nuk kanë pasuri të paluajtshme/shtëpi ose banesë (dëshmi: vërtetimi).

- Lartësia e të ardhurave

1. Vërtetim se familja është shfrytëzuese e asistencës sociale (dorëzohet në versionin e fotokopjuar)
2. Vërtetim nga Enti i Punësimit për të gjithë anëtarët të paraqitur si punë kërkues e të cilët nuk janë të punësuar (vërtetimi nxirret në Qendrën e Punësimit)
3. Çdo anëtarë i familjes i cili është në marrëdhënie pune në Organet Shtetërore apo Private, të sjellët vërtetim nga punëdhënësi ku përcaktohet paga neto dhe pozita e punës
4. Vërtetim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që kërkuesi apo anëtarët e familjes nuk ushtrojnë aktivitet tregtarë
5. Vërtetim nga organi përgjegjës për deklarimin e të ardhurave për personat në pension (dorëzohet në versionin origjinal)
6. Certifikata për pasuri të paluajtshme/tokë e aplikuesit dhe anëtarëve të familjes nga 18 vjeç e më të vjetër duke potencuar informata edhe për prindin e vdekur ose kujdestarëve (vërtetimi nxjerrët në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë-Gjakovë)
7. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës për aplikuesin dhe anëtarët e familjes nga 18 vjeç e tutje,
8. Provë mbi pasqyrën financiare të llogarisë bankare për aplikuesin dhe pjesëtarët e punësuar në periudhën e fundit 1 vjeçare
9. Vendimet e pensioneve të personave me aftësi të kufizuar të lëshuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale për pjesëtarët e familjes.

- Gjendja Shëndetësore

1. Vërtetim nga mjeku specialist apo komisioni i mjekëve për familjet me sëmundje të rënda kronike e me probleme të përhershme shëndetësore, persona të sëmurë me sëmundje kronike si : sëmundjet malinje, sëmundje të rënda gjaku, diabeti tek rastet e rënda me insulina, dializa, alergjitë e ndryshme të rënda, tuberkuloz, sklerozë, epilepsi dhe sëmundje të rënda të zemrës dhe neurozat, për aplikuesin dhe anëtarët e familjes.
2. Certifikata e mjekut për aftësi të kufizuara për aplikuesin dhe familjarët.

- **Invaliditeti**

Provë ose vërtetim mbi shkallën e invaliditetit sipas kushteve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr 21/2010 për Përcaktimin e radhës së përparësisë.

- **Struktura e familjes dhe kriteret shtesë**

1. Deklarata e bashkësisë familjare (Certifikata nxjerrët në Sektorin e Gjendjes Civile, Drejtoria për Pune të Përgjithshme Administrative).
2. Ekstrakti i lindjes për aplikuesin.
3. Certifikata e lindjes për të gjithë anëtarët e familjes.
4. Vërtetim mbi vendbanimin e përhershëm.
5. Certifikata e kurorëzimit për personat e martuar, për bashkëshortin/ten e parashtruesit të kërkesës -aplikuesit
6. Certifikata e shkurorëzimit për çiftet e divorcuara të cilët kanë një ose më shumë fëmijë në përkujdesje prindërore (të dorëzohet në origjinal apo i vërtetuar tek noteri vendimi gjyqësorë për përkujdesje prindërore të fëmijëve).
7. Për fëmijët nga mosha 6-18 vjeç dhe 18-25 vjeç, qe vijnë shkollimin të dorëzohet vërtetim nga shkolla.
8. Vërtetim për viktimë civile të bashkëshortit/tes (merret në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale).
9. Vërtetim mbi statusin e familjes së dëshmorit.
10. Vërtetim që aplikuesi nuk ka përfituar nga programi për rindërtim.
11. Familja që ka në përkujdesje fëmijë/jetim (vërtetim përkatës qe merret në Qendrën për Punë Sociale në Gjakovë.

Dokumentet e lartë cekura duhet të jenë të vlefshme sipas afateve të përcaktuara me ligj dhe nuk lejohet të jenë me të vjetra se gjashtë muaj që nga dita e lëshimit.

Nëse ekziston nevoja për qartësi shtesë do të kërkohen edhe tjera dokumente shtesë.

Vërejtje: Njoftohen të gjithë shfrytëzuesit aktual të njësive banesore ne objektin e Banimit Social-blloku I dhe blloku II, që të paraqesin kërkesën për aplikim për programe të veçanta të banimit. Mos paraqitja e kërkesës së bashku me dokumentacionet e lartpërmendura nënkupton që të njëjtit heqin dorë nga shfrytëzimi i njësive përkatëse banesore.

Për çdo informatë dhe paqartësi ju mund të drejtoheni në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale